



Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nenit 9, bazuar Statutin e Komunës së Klinës Nenin 40. Me propozim-vendimin Nr.434-25380/20 datë 04.09.2020 nga Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, Kuvendi i Komunës së Klinës në mbledhjen e –VI- të rregullt për vitin 2020 të mbajtur me datë 25.09.2020 mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021

-I-

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Klinës cakton normat tatimore për vitin 2021 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave-----0.15% (norma tatimore)
- Për njësitë bujqësore të objekteve-----0.15% (norma tatimore)
- Për njësitë pyjore të parcelave-----0.15% (norma tatimore)
- Për njësitë rezidenciale të parcelave---0.15% (norma tatimore)
- Për njësitë rezidenciale të objekteve-- 0.20% (norma tatimore)
- Për njësitë komerciale të parcelave----0.15% (norma tatimore)
- Për njësitë komerciale të objekteve----0.15%(norma tati), ishte 0.20%
- Për njësitë industriale të parcelave-----0.15%(norma tatimore)
- Për njësitë industriale të objekteve-----0.15%(norma tatimore)

-II-

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për FEZH dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

-III-

Vendimi është i plotfuqishëm më miratimin nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas protokollimit në MPL.

Me këtë vendim njoftohen : MPL, Kryetari i Komunës ,Drejtoria e FEZH, Zyra për Informim, Shërbimi për punë të Kuvendit, Arkivin e Komunës.

Nr.01 060-28281 /2020
Datë: 01.10 /2020



Kryesuesi
Radif GASHI